

SISTEMIMI NË SHKOLLË FËMIJËT DHE BOTA ELEKTRONIKE PRINDËRIT U NDIHMOJNË FËMIJËVE TË RUHEN, TË JENË TË LUMTUR DHE TË MËSOJNË



HYRJE

Televizioni, Interneti, gazetat dhe revistat, telefonat celularë dhe lojërat elektronike e luajnë rolin e vet duke i ndihmuar vajzës apo djalit tuaj që të krijojë kuptimin e vet për botën.

Këto forma të teknologjisë mund të luajnë rol pozitiv në zhvillimin mendor, fizik dhe social të fëmijës tuaj gjatë kohës sa ai/ajo ndjek shkollën fillore. Mirëpo qëndrimi tepër i gjatë pa mbikëqyrje përpara televizorit, kompjuterit, telefonit celular apo ekranit të lojërave elektronike mund të ndikojë në shëndetin e tyre dhe t'u pengojë në mësim.

ORGANIZIMI I KOHËS SË KALUAR PARA EKRANIT

- Nxitini fëmijët tuaj që të merren me veprimtari të tjera. Loja, leximi, tregimi i përrallave, futbollit, vrapimi, ecja apo çiklizmi e ndihmojnë zhvillimin fizik, mendor dhe zhvillimin e aftësive sociale që janë shumë të rëndësishme për rritjen e fëmijës. Nxitini fëmijët tuaj që të merren me një hobi.
- Mendoni se si mund ta kaloni kohën me fëmijët dhe me familjen tuaj në vend që të shikoni televizor apo të luani në kompjuter. Për shembull të lexoni diçka së bashku, ta bëni së bashku një vizitë në muze, në kopsht zoologjik apo në bibliotekë, ose një shëtitje për të ushqyer rosakët? E gjithë familja do të përfitonte si nga ana e argëtimit ashtu edhe nga ana e formës dhe shëndetit fizik.
- Vendosni ju vetë se sa kohë mund të shpenzojë fëmija juaj përpara televizorit, lojërave elektronike apo kompjuterit. Zakonisht rekomandohet që fëmijët e kësaj moshe të mos shpenzojnë më shumë se dy orë në ditë përpara ekranit (qoftë i televizorit, kompjuterit apo lojërave elektronike).

VENDOSJA E RREGULLAVE

- Përpiquni që të gjithë kujdestarët t'u përmbahen rregullave të njëjta, përfshirë këtu gjyshërit, motrat, vëllezërit dhe dadot. Edhe rregullat në shtëpitë e prindërve të ndarë duhet të përputhen.
- Është më e lehtë që rregullat t'i vëni tani (nëse s'i keni vënë ato ende). Sa më shumë të rritet vajza apo djali juaj, aq më e pak do të mund t'i ndihmoni që ai/ajo të vendosë vetë për gjërat e rëndësishme.
- Kallxojuni fëmijëve që njëherë duhet të mbarohen të gjitha detyrat e shtëpisë dhe përgjegjësitë e ngarkuara para se të shikojnë televizor. Në këtë mënyrë edhe kënaqësia do të jetë më e madhe.
- Shikoni televizor, hyni në internet, luani lojëra dhe dëgjoni muzikë sa më shumë së bashku. Diskutoni me vajzën apo djalin tuaj për gjërat që shihni dhe dëgjoni.

ORIENTOJENI FËMIJËN TUAJ TË SHOHE ATË QË DUHET

- Orientojini fëmijët drejt materialeve të duhura edukuese që nuk përmbajnë dhunë, seks dhe gjuhë fyese. Përgëzojini ata kur zgjedhin gjërat e duhura. Diskutoni me ta arsyet se pse ata nuk mund t'i shohin disa lloje programesh.
- Diskutoni vlerat edukuese të një programi që merret me rëndësinë e shfrytëzimit të përbashkët të gjërave, me rëndësinë e dhënies, dashurisë ose me rëndësinë e mësimt

të përbashkët të alfabetit. Ndërmerrni ndonjë veprimtari shoqëruese që e zhvillon më tej materialin e paraqitur në program.

- Informohuni për vlerësimet dhe klasifikimet që u bëhen filmave dhe lojërave elektronike, meqë këto ju ndihmojnë për të vendosur nëse ato janë të përshtatshme për fëmijët e vegjël apo jo.
- Kufizoni sasinë e dhunës me të cilën ballafaqohet fëmija juaj, qoftë edhe në filmat vizatimorë, dhe vëzhgoni sjelljen e tyre pasi të kenë parë emisione të frikshme, apo pasi të kenë luajtur me lojëra elektronike.
- Jini të vetëdijshëm se nëse vendosni televizor, kompjuter apo lojëra elektronike në dhomën e fëmijëve tuaj, ata mund t'i përdorin ato edhe kur ju mendoni se ata janë në gjumë.
- Përmbajuni kohës së gjumit dhe rutinës së darkës. Lexojuni fëmijëve ndonjë tregim para gjumit dhe nxitini ata që të jepen pas librave.
- Kontrolli prindëror në kompjuter mund të përdoret për të parandaluar futjen e fëmijës tuaj nëpër website të papërshtatshme si websitet pornografike apo dhomat e bisedave.
- Përkujtojini kujdestarët si dadot, kujdestarët e ditës dhe gjyshërit që të mos shikojnë materiale të papërshtatshme para fëmijëve.
- Nëse është e mundur fikeni televizorin gjatë vakteve të ushqimit, kur vijnë mysafirë dhe gjatë kohës së mësimin.

Për informata dhe këshilla të mëtejme:

Parentline – 0808 800 2222 www.parentlineplus.org.uk

NSPCC – 0808 800 5000 www.nspcc.org.uk

National Family & Parenting Institute – 020 7424 3460 www.nfpi.org

The British Association for Early Childhood Education – 020 7539 5400

www.early-education.org.uk

www.safekids.com për këshillim mbi përdorimin e sigurt të Internetit dhe mbi kontrollin prindëror

Ju lutemi shënojeni në vazhdim njoftimet lokale dhe mundësitë e kontaktimit

Të gjitha të drejtat e rezervuara © Crown, gusht 2006.